

7188  
11/05/2016



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT**

**Nr. 5996/1528/110 Regjistri Themeltar**  
**Datë 10.07.2014 regjistrimi**

**Nr. 864 Vendimi**  
**Datë 25.04.2016**

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët:

- Kryesues : Kastriot SELITA**
- Anëtare : Bernina KONDI**
- Anëtare : Altina NASUFI**

Asistuar nga sekretare gjyqësore Raimonda Aliaj, në Tiranë në datë 25.04.2016 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen administrative me nr. 5996/1528/110 regjistri themeltar, me palë ndërgjyqëse:

**PADITËS :** Shoqëria “Akull” shpk, me adresë ne Qafë-Mali të rrethit Pukë.

**TE PADITUR :** Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, përfaqësuar në gjykim nga juristja Siriana Bakushi, përfaqësuese me autorizim.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, (Drejtoria e Apelimit Tatimor), Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga juristja Siriana Bakushi, përfaqësuese me autorizim.

Në prani të Avokaturës së Shtetit, përfaqësuar në gjykim nga av.shteti Irida Selhani.

**OBJEKTI :** Kundershtimin e aktit administrativ te DRT Shkoder Nr. 5522 dt. 03.07.2013 për 100.000 leke dhe Nr. 3684/4 dt. 30.07.2013 per 500.000 leke.

## **BAZA LIGJORE:**

Neni 153, 154, e vijues te K.Pr. Civile. Neni 7/a, 11/1, 15/a, 17/a e vijues te Ligjit Nr. 49/2012 dt. 03.05.2012; Neni 23, 29, 30, 32, 68, 69, 80, 83, 106, 107, 108, 111, 115, 116, 119, 122 e vijues te Ligjit Nr. 9920 dt. 19.05.2008 " Per Procedurat Tatimore" i ndryshuar dhe Udhezimit Nr. 24 dt. 02.09.2008 " Per Procedurat Tatimore ne R.Sh." Ieshuar ne zbatim te tij; Neni 116, 117 e vijues te ligjit Nr. 8485 dt. 12.05.1999 " Per Procedurat Administrativene R.Sh."

### **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr. 11, datë 10.01.2014 ka vendosur:**

-Rrëzimin e kërkesë padisë.

-Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

-Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar që nga e nesërmja shpalljes së këtij vendimi, për palën paditëse, shoqëria Akulli shpk, ky afat fillon nga e e njohlimit të vendimit.

**-Me dëftesën e komunikimit nr.82/24 datë 20.01.2014 të Gjykatës Administrative Shkodër, rezulton se në datë 23.01.2014 ndaj vendimit të mësipërm ka marrë dijeni përfaqësuesi i palës paditëse Gjon Nikolli.**

**-Kundër këtij vendimi në datë 05.02.2014 ka paraqitur ankim pala paditëse, shoqëria Akull shpk, duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e Vendimit datë 10.01.2014 të Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Shkodër si dhe pranimin e kërkesë padisë:**

-Shoqëria "Akull" shpk nuk i ka kryer shkeljet tatimore të shitjes pa kasë fiskale dhe të mosdeklarimit të punonjësve, për të cilat dhe është ndërshkuar me gjobë. Këto sqarime dhe fakte i kemi radhitur edhe në kërkesën për apelim të datës 06.08.2013.

-Shitjen e ujit të pijshëm që realizohej me furgonin me targa AA 802AU, në të cilin dhe është konstatuar shkelja është i rregjistruar si vend biznesi më vete dhe ka kasë fiskale në adresë sekondare. Shoferi dhe shitësi i mallit Edmond Nikolli është punonjës i shoqërisë dhe i siguruar nga shoqëria. Ai datën e konstatimit ka parkuar mjetin pranë Spitalit Ushtarak Tiranë dhe ka filluar në tregtojë mallin, por kur ka bërë gati mallin për shitje ai ka konstatuar se kasa nuk punonte. Ndërkohë sic rezulton ai ka patur në punë një pasagjer shtetasin Mark Deda, Edmond Nikolli është larguar për një moment për rregulluar kasën fiskale, e cila nuk punonte, ndërkohë janë paraqitur inspektorët e

verifikimit në Terren të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, që kanë konstatuar shkeljet përkatëse.

-Pra subjekti rezulton i pajisur me kasë dhe personi që punon me këtë mjet të shoqërisë sonë "Akull", Etmond Nikolli është i siguar dhe për derdhen rregullisht nga shoqëria kontributet e sigurimeve shoqërore. Pra ndodhemi në kushtet kur pala paditëse nuk ka konsumuar asnjërin nga kundërvajtjet administrative, për të cilat dhe është penalizuar.

-Nga sa më sipër kërkojmë nga Gjykata Administrative e Apelit ndryshimin e vendimit dhe rrezimin e padisë.

**-Ankimi i palës paditëse i është komunikuar palëve të paditura në proces, me dëftesë komunikimi.** Ndaj këtij ankimi, pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, pasi ka marrë dijeni në datë 05.05.2016 me anë të dëftesës së komunikimit nr.82/24 prot datë 02.05.2014, ka paraqitur kundërankim, në të cilin ka kundërshtuar ankimin e paraqitur nga pala paditëse, duke kërkuar "Lënien në fuqi të vendimit nr.11 datë 10.01.2014", me argumentat e mëposhtme ligjore të cilat rezultojnë të jenë në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

- Pretendimet e palës paditëse nuk janë të bazuara në prova dhe ligj dhe si të tilla duhet të rrezohen.

-Rezulton se në zbatim të detyrave funksionale të percaktuara në Udhezimin nr. 16 datë 03.05.2010, Inspektoret e Zbatimit në Sektorin e Hetimit në DRT-Tiranë, kanë mbajtur proces-verbalin nr. 006838 datë. 24.04.2013, ndaj tatimpaguesit, sot paditës në këtë proces, ku përshkruajnë ndër të tjera se ; " *Gjate kontrollit të ushtruar në mjetin e transportit me targa AA802AU, është konstatuar se subjekti nuk është i pajisur me kasë fiskale në momentin e kontrollit*". Për këtë ndaj subjektit është vendosur masa e gjobes për shumën 100.000 leke bazuar në nenin 122/1/i të Ligjit Nr. 9920 dt. 19.05.2008 " *Për Procedurat Tatimore në R.SH*". Nga verifikimi në sistemin e pajisjeve fiskale PROGRAMI NEXUS, ka rezultuar se subjekti Akulli është pajisur me kasë fiskale me datë 06.08.2013, për mjetin e transportit me targa AA802AU, pra pas kontrollit të ushtruar dhe konstatimit nga inspektoret tatimor. Përse më sipër pretendimi i subjektit se kasa ka qenë me defekt bie, pasi ky subjekt nuk ka patur fare kasë fiskale për furgonin me targa AA802AU deri me datë 06.08.2013 dhe me të drejtë nga administrata tatimore është ndeshkuar me gjobe për shkeljen administrative të faktuar dhe të konstatuar.

-Nga inspektoret e Kontrollit në Seksionin e Verifikimit në Terren të DRT-Shkoder, është përparuar akt-konstatimi me nr. Serie 0326614 dt.09.07.2013 sipas të cilit subjekti tatimpagues nuk kishte deklaruar si të rregjistruar si punojës të saj z. Mark Deda dhe me proces-verbal me nr. Serial 0064215 dt.09.07.2013 ndaj subjektit paditës është aplikuar gjoba në masën 800.000 leke, bazuar në nenin 119 " *Mosdeklarimi i të*

bazën e të cilit më pas ndaj shoqërisë paditëse nga ana e DRT-Shkodër është nxjerrë njoftim vlerësimi tatimor nr.5522 datë 03.07.2013, i cili dënon shoqërinë paditëse me gjobë në masën 100.000 lekë.

Ndërsa sa i takon personit të gjendur në punë në mjetin e shoqërisë paditëse, Mark Deda, nga ana e inspektorëve të verifikimit është mbajtur procesverbali i gjobës me nr.serie 0068638 datë 24.04.2013. Më pas nga verifikimet e kryera nga Sektori i Vlerësimit pranë DRT Shkodër ka rezultuar se ky shtetas nuk është i deklaruar si punonjës në listëpagesat e periudhës 2013/04 nga subjekti "Akull"shpk. Drejtoria e Vlerësimit me shkresën nr.3684/1 prot datë 02.07.2013 ka informuar DRT-Shkodër lidhur me këtë situatë.

Bazuar në sa më sipër është nxjerrë njoftim vlerësimi tatimor nr.3684/4 prot datë 30.07.2013 i DRT-Shkodër, me anë të të cilit shoqëria është penalizuar me gjobë në masën 500.000 lekë, për punonjës të padeklaruar.

Ndaj njoftim vlerësimeve nr.5522 datë 03.07.2013 dhe nr.3684/4 prot datë 30.07.2013 të DRT-Shkodër, shoqëria paditëse "Akull"shpk, rezulton të ketë ushtruar ankim në Drejtori të Apelit Tatimor, me kërkesë ankimore, duke kërkuar shfuqizimin e këtyre dy akteve.

Në përgjigje të kësaj kërkesë ankimore, Drejtoria e Apelit Tatimor me vendimin e saj nr.15383/1 prot datë 25.10.2013, ka vendosur "Lënien në fuqi të njoftim vlerësimit tatimor nr.5522 prot datë 03.07.2013 dhe nr.3684/4 prot datë 30.07.2013 të DRT-Shkodër.

Pas kësaj shoqëria paditëse, duke mos qënë dakord me aktet e mësipërme administrative, njoftim vlerësimin tatimor nr.5522 prot datë 03.07.2013 dhe nr.3684/4 prot datë 30.07.2013 të DRT-Shkodër, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me kërkesë-padinë objekt gjykimi, duke kërkuar kundërshtimin e këtyre dy akteve administrative si të nxjerra në kundërshtim me ligjin.

## **II.Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër:**

Gjykata ka rrëzuar padinë me argumentimin si vijon:

Së pari: Në zbatim të Ligjit nr.9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar në nenin 122 pika 1, gërma "a", "i" është parashikuar se :

*" Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:*

*a) nuk instalon pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë:*

i) herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale, për të cilën është përcaktuar një afat vendosjeje deri në 10 ditë pune, me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë”.

Ndërsa germa ‘gj’ e nenit 122, parashikon si një kundërvajtje të veçantë rastin kur tatimpaguesi nuk njofton menjëherë për defektin e ndodhur në pajisjen fiskale dhe nuk plotëson në rregull librezën fiskale të defekteve.

Në interpretim të kësaj dispozite, paditësi ka detyrimin të lajmërojë anën e paditur në rastin e prishjes së kasës fiskale, pasi është pikërisht ana e paditur, e cila mbas informimit për defekt për kasën lejon riparimet përkatëse tek servisi sipas kontratës. Paditësi nuk paraqiti asnjë provë (faturë riparimi të kasës) të cilën pretendoi se në momentin e kontrollit ka qënë tek servisi për riparim për të provuar se ka respektuar kriteret e nenit 122 të ligjit nr.9920/2008.

Së dyti: Në udhëzimin nr.24/2008, pika 119.1 “Mosdeklarimi i të punësuarve”, shprehet se “Organet tatimore duhet të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratimet e detyrimeve tatimore si dhe të kontributeve janë të plota dhe të sakta. Të gjithë tatimpaguesit duhet të deklarojnë të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës cdo të punësuar.

Në mbështetje të nenit 119 të Ligjit nr.9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", punonjësit e administratës tatimore të autorizuar me shkrim kryejnë verifikime dhe kontrole në vendodhjen e biznesit lidhur me deklaratimet e numrit të punonjësve. Bazuar në këtë dispozitë ligjore nëse nga kontrolli në vendodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor, çdo të punësuar rishtas pranë tij të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës, tatimpaguesi përkatës është i detyruar të paguajë edhe një gjobë prej 500.000 lekësh, kur është tatimpagues i rregjistruar njëkohësisht për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tatim fitimin, sic është edhe shoqëria paditëse. Në gjykim paditësi nuk provoi dot para gjykatës se pretendimin e parashtruar në kërkesë padi, që Mark Deda i pranishëm në momentin e kontrollit, po ruante furgonin si i afërm i shoferit-kur ai ishte i larguar për tek servisi i kasës.

Pra në mungesë të provueshmërisë së pretendimeve të parashtruara në kërkesë padi si dhe nga ana tjetër në mbështetje të argumentave mbi bazë ligji dhe prove të parashtruar në gjykim nga ana e DRT-Shkodër, e cila konform nenit 35 të ligjit nr.49/2012 ka barrën e provës, Gjykata krijon bindjen se kërkesë padia është e pambështetur në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet të rrëzohet.

### III. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Sic rezulton me kërkesën nr. prot 16/4 datë 16.04.2016, protokolluar pranë Gjykatës Administrative të Apelit në datë 18.04.2016 me nr. prot 886, shoqëria paditëse "Akull" shpk, nëpërmjet administratorit të saj Gjon Nikolli, ka kërkuar bazuar në nenin 201/1 të Kodit të Procedurës Civile, pushimin e gjykimit të çështjes administrative me nr. 5996 datë rregjistrimi 10.07.2014 që i përket vendimit nr. 11 datë 10.01.2014 të Gjykatës Administrative Shkodër, për shkak të zgjidhjes dhe trajtimit të çështjes objekt gjykimi me Ligjin nr. 39/2014 datë 17.04.2014 "Për faljen e dënimeve administrative në formën e gjobave të vëna në bazë të kontrolleve dhe verifikimeve tatimore të kryera për periudhën 1 mars deri më 31 gusht 2013".

Lidhur me sa më sipër konstatuar Gjykata Administrative e Apelit referon në dispozitat e mëposhtme ligjore, konkretisht:

Ne Kreun IV të ligjit nr. 49/2012 janë sanksionuar "Subjektet dhe kushtet formale padise". Konkretisht në nenin 14 janë parashikuar të drejtat dhe detyrat e palëve, ku citohet: "Palët, përfaqësimi, të drejtat dhe detyrat e palëve dhe të përfaqësuesve, përgjegjësia e palëve për shpenzimet dhe për dëmet gjatë procesit, pjesëmarrësit e tjerë në gjykim rregullohen sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato nuk bien ndesh me përmbajtjen e këtij ligji".

Neni 39/3 i ligjit nr. 49/2012 përcakton: "Gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë".

Neni 201 i K.Pr.Civile përcakton: "Paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Në këtë rast gjykata vendos pushimin e gjykimit".

Duke interpretuar nenin e mesipër si dhe institutin e heqjes dore nga gjykimi i padisë, Gjykata Administrative e Apelit konkludon se heqja dore nga gjykimi i padisë mund të bëhet në çdo fazë të gjykimit. Kur paditësi bazuar në parimin e disponibilitetit heq dorë nga gjykimi i mëtejshëm i padisë, e drejta e tij subjektive nuk shuhet, por ajo mund të kërkojë në çdo kohë në gjykatë duke investuar perseri gjykatën.

Neni 39/3 i ligjit nr. 49/2012 dhe neni 201 i K.Pr.Civile autorizon në mënyrë eksplicite gjykatën të disponojë për të hequr dorë nga gjykimi kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë.

Një përfundim i tillë bazuar në dispozitat e mësipërme të ligjit nr. 49/2012 dhe 299/c i K.Pr.Civile i cili autorizon gjykatën të heqë dorë nga gjykimi i padisë, përforcohet me tejet të drejtë dhe rrethimisht gjykatën të pushojë gjykimin dhe të heqë dorë nga gjykimi i padisë.

nga gjykimi i padise dhe te pushoje gjykimin kur nje gje e tille parashikohet shperhimisht ne ligj. Neni 39/3 i ligjit nr. 49/2012, neni 201 i K.Pr.Cvile ne lidhje me nenin 299/b dhe 299/c e K.Pr.Civil orientojne dhe bejne kompetente gjykatën, te pushoje gjykimin kur pala paditese heq dore nga gjykimi i metejshem i padise.

Ndodhur ne keto kushte Gjykata Administrative e Apelit çmon se çështja, qe mbart mosmarrveshjen e paraqitur per gjykim, bazuar ne parimin e disponibilitetit te se drejtes nga vete pala qe e pretendon kete te drejte, duhet te pushohet, pasi pala kerkuese, e kerkon nje gje te tille.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50. shkronja "d" e ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar

### VENDOSI :

- Pushimin e gjykimit të çështjes me nr.5996/1528/110 datë 10.07.2014 rregjistrimi në Gjykatën Administrative të Apelit.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve afat që fillon nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit.

-Tiranë, më 25.04.2016

**ANËTARE**

**Altina NASUFI**  
D.V

**ANËTARE**

**Bernina KONDI**  
D.V

**KRYESUES**

**Kastriot SELITA**  
D.V

Vertetohet njësia me origjinalin

*Leonard Stankaj*  
*Stankaj*